



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE, ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT  
SEKTORI I ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. 1 datë 23.11. 2023

**“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË  
ANËTARËVE TË KËSHILLIT VENDOR TË RINISË SI DHE MËNYRËS SË  
ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË TIJ”**

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8, pika 1 dhe 2; të Ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë” neni 10, pika 3; Manual udhëzues operacional për Këshillat Vendor Rinor, i propozojmë Këshillit të Bashkisë, të:

**VENDOSI**

1. Miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë (KVR), dhe të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij.
2. KVR udhëhiqet nga parimet e gjithëpranuara të ushtrimit të detyrave në përmbushje të interesit publik dhe në veçanti nga parimi i ligjshmërisë, transparencës, mosdiskriminimit, përgjegjshmërisë dhe objektivitetit.
3. Ngarkohet Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria E Burimeve Njerëzore, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

**Konceptoi Projekt-Vendimin:** Melita Vjerdha  **Miratoi:** Devis Peci 

**KRYETARI**  
**Kristian SHKRELI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZV/KRYETARI**  
**Gjovalin ZEFI**



Adresa, Rruga “Qafa e Gurit” Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@vaudejes.gov.al



**Shtojcë:**

### **I. Qëllimi dhe funksioni i Këshillit Vendor Rinor:**

Me daljen e Ligjit nr 75/2019 “Për Rininë”, neni 10, pika 1,2 dhe 3, është parashikuar ngritja e Këshillit Vendor të Rinisë, si organ këshillimor, që funksionon pranë Kryetarit të Bashkisë, si më poshtë:

*1. Këshilli vendor i rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. Këshilli vendor i rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme:*

- a) këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;*
- b) vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;*
- c) propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;*
- d) ç) bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.*

*2. Këshilli vendor i rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e këshillit vendor të rinisë emërohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.*

*3. Kriteret, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit vendor të rinisë, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të këshillit vendor të rinisë miratohen me vendim të këshillit bashkiak, duke iu referuar, për aq sa është e mundur, kriterëve dhe procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për Këshillin Kombëtar të Rinisë.*

### **II. Kriteret dhe procedurat të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor në Bashkinë Vau Dejës.**

Referuar këtij detyrimi të parashikuar nga ligji, dhe mbështetur tek “Manuali Udhëzues Operacional për Këshillat Vendor Rinor”, dhe praktika të bashkive të tjera, propozohet ngritja e këtij Këshilli Vendor Rinor dhe miratimi i kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve, si më poshtë:

Adresa, Rruga “Qafa e Gurit” Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: [info@vaudejes.gov.al](mailto:info@vaudejes.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

1. KVR-ja përbëhet të paktën nga 4 (katër) deri në 6 (gjashtë), ku të respektohet parimi i barazisë gjinore.
2. Përbërja e KVR-së vijon si më poshtë:
  - a) Kryetari i Bashkisë (kryeson);
  - b) Përfaqësues i administratës ( Sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit);
  - c) 2 (dy) ose më shumë përfaqësues nga organizatat rinore ose organizatat për të rinjtë (anëtar);
  - d) 2 (dy) ose më shumë përfaqësues të rinjë aktiv të njësive administrative përbërëse.
3. Anëtarët e Këshillit Vendor Rinor emërohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë dhe mandati i tyre është dy vjeçar, me të drejtë riemërimi.
4. Anëtari i KVR-së, mund të japë doreheqjen në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim Kryetarin. Anëtari i dorehequr është i detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet e lëna deri në miratimin e urdhërit të ndryshimit.
5. Kryetari mund të vëndos edhe për përjashtimin e ndonjë anëtari në rast të mosparaqitjes në takime për më shumë se tre herë rradhazi ose në raste të mospërmbushjes së funksioneve. Anëtari zëvendësues plotëson mandatin e anëtarit që zëvendëson.
6. Anëtarët e KVR-së duhet të deklarojnë çdo rast të konfliktit të mundshëm të interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Anëtarët e KVR-së kryejnë detyrën e tyre bazuar në parimin e mos-diskriminimit, të meritës, transparencës dhe gjithë-perfshirjes.

### **III.Procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor të Bashkisë Vau Dejës.**

1. Kandidatët për anëtar të KVR-së identifikohen dhe shprehin interesin në bazë të një thirrje për shprehje interesi për të marrë pjesë në KVR, të hartuar e të njoftuar nga Kryetari, në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e Bashkisë dhe/ose në rrjetet sociale të institucionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

2. Përzgjedhja mes individëve të cilët kanë shprehur interes, bëhet nga Kryetari duke u bazuar në kriterin e përvojës së mëparshme me organizatat jofitimprurëse dhe në projektet të cilat lidhen me të rinjtë.
3. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtar të KVR-së, *përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë*, bëhet nga Kryetari dhe bazohet në kriteret e mëposhtme:
  - a) Të jetë anëtar i një organizate rinore ose për të rinjtë;
  - b) Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - c) Të ketë përvojë në projektet, nisma dhe veprimtari rinore dhe për të rinjtë;
  - d) Të mos ketë konflikt interesi për shkak të angazhimit në KVR.
8. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtar të KVR-së, *përfaqësues nga të rinj të njësive administrative*, bëhet nga Kryetari dhe bazohet në kriteret e mëposhtme:
  - a) Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - b) Të jetë i përfshirë në organizime dhe në zbatimin e aktiviteteve rinore apo në promovimin e të rinjëve;
  - c) Të mos ketë konflikt interesi për shkak të angazhimit në KVR.
9. Kandidatët për t'u emëruar anëtar i KVR-së, duhet të aplikojë brenda afatit dhe në adresën e përcaktuar në njoftimin përkatës duke paraqitur dokumentat e mëposhtme:
  - A. Kandidatët *përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë*:
    - Kërkesë me shkrim ku të shprehë interesimin për aplikim;
    - Jetëshkrimin (CV);
    - Fotokopje të dokumentave që mbështesin shënimet e jetëshkrimit;
    - Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore;
    - Vetëdeklarimin lidhur me shmangien e konfliktit të interesave;  
Referenca nga të paktën 1 (një) bashkëpunëtorë i mëparshëm.
  - B. Kandidatët *përfaqësues nga të rinj aktiv të njësive administrative*:
    - Kërkesë me shkrim ku të shprehë interesimin për aplikim;
    - Jetëshkrimin (CV);



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Fotokopje të dokumentave që vertetojnë dhe mbështesin shënimet e jetëshkrimit;
  - Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj;
  - Letër ineresi/motivimi;
  - Vetëdeklarimin e konfliktit të interes.
10. Shqyrtimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e tyre bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e mbylljes së aplikimeve.
11. Rezultati i përzgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor (KVR), do shpallet nga Kryetari i Bashkisë dhe publikohet në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e Bashkisë dhe/ose në rrjetet sociale të institucionit.

**IV. Të miratojë mënyren e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Vendor Rinor si më poshtë:**

1. Këshilli Vendor Rinor është organ këshillimor, që funksionon pranë Kryetarit të Bashkisë. KVR ushtron kompetencat e mëposhtme, sipas Ligji 75/2019 "Për Rininë", neni 10, pika 1:
  - a. këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
  - b. vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
  - c. propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku vepron;
  - d. bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.
2. KVR-ja mbledhet jo më pak se 4 (katër) herë në vit. Mbledhjet thirren dhe drejtohen nga Kryetari.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. Mbledhjet e KVR-së zhvillohen kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtar. Nëse nuk paraqiten në mbledhje numri minimal i anëtarëve pjesëmarrës, takimi shtyhet për një datë të mëvonshme.
4. Veprimtaria e KVR mbështetet nga Sekretariatit teknik i cili përbëhet nga (1) një ose më shumë punonjës të bashkisë të ngarkuar nga Kryetari me këtë detyrë. Caktimi i anëtarëve të sekretariatit teknik e procedura e thirrjes së mbledhjes apo elemente të tjera për funksionimin e KVR-së, përcaktohen në rregulloren e brendshme, e cila miratohet nga Kryetari i Bashkisë për rininë.
5. Sekretariati teknik thërret mbledhjet në bazë të nevojave që shprehen nga radhët e Kryetarit ose të anëtarëve.
6. Sekretariati teknik njofton anëtarët e KVR-së, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara për datën dhe orën e takimit, si dhe rendin e ditës.
7. Në çdo mbledhje të KVR-së mbahet procesverbali nga sekretariati teknik që pasqyron minutat e takimit dhe të gjitha diskutimet gjatë mbledhjes. Procesverbali nënshkruhet nga çdo pjesëmarrës në mbledhjen përkatëse të KVR-së.
8. Mandati i anëtarit të KVR-së mbaron kur:
  - a. përfundon afati dyvjeçar nga data e emërimit;
  - b. humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykate apo dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - c. jep dorëheqjen.
9. Anëtari i Këshillit Vendor të Rinisë lirohet nga detyra, para mandatit, nga kryesuesi i KVR me më shumë se  $\frac{1}{2}$  e votave, në rastet kur:
  - a. nuk paraqitet, pa shkaqe të justifikuara, në të paktën 3 (tri) mbledhje të njëpasnjëshme të KVR-së;
  - b. paraqiten shkaqe objektive, që e bëjnë të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;
  - c. nuk përmbush detyrimet si anëtar i KVR-së;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

d. veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e KVR.

10. Anëtari i KVR-se, të cilit i është ndërprerë mandati apo është liruar nga detyra, zëvendësohet nga kryesuesi dhe sekretariati teknik me një kandidat që përmbush kriteret e percaktuara në këtë vendim, i cili ka qënë i kandiduar.
11. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit zëvendësues është sa pjesa e mbetur e mandatit të anëtarit të larguar.
12. Anëtari pajiset me referencë të lëshuar nga Kryetari i Bashkisë për kontributin e dhënë në sektorin e rinisë.

#### **V. Të miratojë detyrat e Këshillit Vendor Rinor si më poshtë:**

1. Promovon projektet dhe iniciativat për të rinjtë iniciuar nga Bashkia Vau Dejës dhe nga organizatat e shoqërisë civile;
2. Këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
3. Merr pjesë në trajnimet e propozuara nga aktorët publik dhe jopublik për ngritjen e kapaciteteve.
4. Vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
5. Nxitë takime, diskutime me të rinjtë në gjithë territorin e Bashkisë Vau Dejës;
6. Propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;
7. Harton, miraton dhe publikon thirrjet për projektpropozime drejtuar organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë;
8. Ndjek dhe zhvillon veprimtari rinore, kulturore, artistike, letrare, sportive, të mbrojtjes së mjedisit dhe edukimin joformal, si dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve, në zbatim të politikave dhe programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për rininë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

9. Jep informacion ndaj të rinjve dhe/ose organizatave rinore për thirrjet për aplikime në projekte rinore të organizatave të ndryshme jofitimprurëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vendin tonë dhe atyre ndërkombëtare;
10. Ofron shërbime të ndryshme komunitare, nëpërmjet sigurimit të pjesëmarrjes aktive të të rinjve, për përmirësimin e jetës shoqërore në komunitetet e tyre;
11. Monitoron zbatimin e projekteve, që kanë përfituar mbështetje financiare.
12. Bashkëpunon me organizata të ndryshme rinore në nivel vendor, qendror dhe rajonal.
13. Ngre sipas nevojave grupe pune për çështje që lidhen me të rinjtë dhe përcakton përbërjen dhe rregullat e funksionimit të tyre.

Konceptoi: P/Sektorit të Arsimit

Melita Vjerdha

Miratoi: Drejtor Drejtorie

Devis Peci





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE, ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT  
SEKTORI I ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT

RELACION

“PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË  
ANËTARËVE TË KËSHILLIT VENDOR TË RINISË SI DHE MËNYRËS SË  
ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË TIJ”

**Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Këshillit Vendor Rinor:**

Me daljen e Ligjit nr 75/2019 “Për Rininë”, neni 10, pika 1,2 dhe 3, është parashikuar ngritja e Këshillit Vendor të Rinisë, si organ këshillimor, që funksionon pranë Kryetarit të Bashkisë, si më poshtë:

*1. Këshilli vendor i rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. Këshilli vendor i rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme:*

- a) këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;*
- b) vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;*
- c) propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;*
- ç) bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.*

*2. Këshilli vendor i rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e këshillit vendor të rinisë emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.*

*3. Kriteret, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit vendor të rinisë, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të këshillit vendor të rinisë miratohen me vendim të këshillit bashkiak, duke iu referuar, për aq-sa është e mundur, kriterëve dhe procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për Këshillin Kombëtar të Rinisë.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## **Kriteret dhe procedurat të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor në Bashkinë Vau Dejës.**

Referuar këtij detyrimi të parashikuar nga ligji, dhe mbështetur tek Manuali Udhëzues Operacional për Këshillat Vendor Rinor, dhe praktika të bashkive të tjera, propozohet ngritja e këtij Këshilli Vendor Rinor dhe miratimi i kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve, si më poshtë:

KVR-ja ushëhiqet nga parimet e gjithëpranuara të ushtrimit të detyrave në përmbushje të interes publik dhe në veçanti nga parimi i ligjshmërisë, transparencës, mosdiskriminimit, përgjegjshmërisë dhe objektivitetit, parashikuar nga pika 1, 2, 3 e Manualit.

KVR-japërbëhet të paktën nga 4 (katër) deri në 6 (gjashtë), ku të respektohet parimi i barazisë gjinore, parashikuar nga pika 3.1 e Manualit.

KVR-ja, do të ketë në përbërje:

- a). Kryetari i Bashkisë (kryeson);
- b). Përfaqësues i administratës ( Sektor i Arsimit, Rinisë dhe Sportit);
- c). 2 (dy) ose më shumë përfaqësues nga organizatat rinore ose organizatat për të rinjtë (anëtar);
- ç). 2 (dy) ose më shumë përfaqësues të rinjë aktiv të njësive administrative përbërëse.

*(Parashikuar nga pika 2.4.1 e Manualit)*

Anëtarët e Këshillit Vendor Rinor emërohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë dhe mandati i tyre është dy vjeçar, me të drejtë riemërimi, parashikuar nga pika 3.2 e Manualit.

Anëtari i KVR-së, mund të japë doreheqjen në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim Kryetarin. Kryetari mund të vendos edhe për përjashtimin e ndonjë anëtari në rast të mosparaqitjes në takime për më shumë se tre herë rradhazi ose në raste të mospërmbushjes së funksioneve. Anëtari zëvendësues plotëson mandatin e anëtarit që zëvendëson, parashikuar nga pika 3.13 dhe 3.14 e Manualit.

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail: [info@vaudejes.gov.al](mailto:info@vaudejes.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Anëtarët e KVR-së identifikohen dhe shprehin interesin në bazë të një thirrje për shprehje interesi për të marrë pjesë në KVR, të hartuar e të njoftuar nga Kryetari, në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e Bashkisë dhe/ose rrjetete sociale të institucionit.

Anëtarët e KVR-së duhet të deklarojnë çdo rast të konfliktit të mundshëm të interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Rinortë Bashkisë Vau Dejës.**

Kandidatët për anëtar të KVR-së identifikohen dhe shprehin interesin në bazë të një thirrje për shprehje interesi për të marrë pjesë në KVR, të hartuar e të njoftuar nga Kryetari, në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e Bashkisë dhe/ose në rrjetet sociale të institucionit.

Përzgjedhja mes individëve të cilët kanë shprehur interes, bëhet nga Kryetari duke u bazuar në kriterin e përvojës së mëparshme me organizatat jofitimprurëse dhe në projektet të cilat lidhen me të rinjtë.

Përzgjedhja e kandidatëve për anëtar të KVR-së, *përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë*, bëhet nga Kryetari dhe bazohet në kriteret e mëposhtme:

- a) Të jetë anëtar i një organizate rinore ose për të rinjtë;
- b) Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- c) Të ketë përvojë në projektet, nisma dhe veprimtari rinore dhe për të rinjtë;
- d) Të mos ketë konflikt interesi për shkak të angazhimit në KVR.

Përzgjedhja e kandidatëve për anëtar të KVR-së, *përfaqësues nga të rinj të njësisve administrative*, bëhet nga Kryetari dhe bazohet në kriteret e mëposhtme:

- a) Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- b) Të jetë i përfshirë në organizime dhe në zbatimin e aktiviteteve rinore apo në promovimin e të rinjve;
- c) Të mos ketë konflikt interesi për shkak të angazhimit në KVR.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kandidatët për t'u emëruar anëtar i KVR-së, duhet të aplikojë brenda afatit dhe në adresën e përcaktuar në njoftimin përkatës duke paraqitur dokumentat e mëposhtme:

A. Kandidatët *përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë*:

- Kërkesë me shkrim ku të shprehë interesimin për aplikim;
- Jetëshkrimin (CV);
- Fotokopje të dokumentave që mbështesin shënimet e jetëshkrimit;
- Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore;
- Vetëdeklarimin lidhur me shmangien e konfliktit të interesave;
- Referenca nga të paktën 1 (një) bashkëpunëtorë i mëparshëm.

B. Kandidatët *përfaqësues nga të rinj aktiv të njësive administrative*:

- Kërkesë me shkrim ku të shprehë interesimin për aplikim;
- Jetëshkrimin (CV);
- Fotokopje të dokumentave që vërtetojnë dhe mbështesin shënimet e jetëshkrimit;
- Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj;
- Letër ineresi/motivimi;
- Vetëdeklarimin e konfliktit të interes.

*Kriteret e përzgjedhjes janë përcaktuar në vlerësimin tonë dhe mbështetur tek praktikat e bashkive të tjera.*

Shqyrtimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e tyre bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e mbylljes së aplikimeve.

Rezultati i përzgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor (KVR), do shpallet nga Kryetari i Bashkisë dhe publikohet në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e Bashkisë dhe/ose në rrjetet sociale të institucionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## **Të miratojë mënyren e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Vendor Rinor si më poshtë:**

Këshilli Vendor Rinor është organ këshillimor, që funksionon pranë Kryetarit të Bashkisë. KVR ushtron kompetencat e mëposhtme, sipas Ligji 75/2019 "Për Rininë", neni 10, pika 1 :

- a. këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
- b. vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
- c. propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;
- d. bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.

KVR-ja mbledhet jo më pak se 4 (katër) herë në vit. Mbledhjet thirren dhe drejtohen nga Kryetari, parashikuar nga pika 3,12 e Manualit.

Mbledhjet e KVR-së zhvillohen vetëm kur janë të pranishëm të paktën tre(3) anëtar. Nëse nuk paraqiten në mbledhje numri minimal i anëtarëve pjesëmarrës, takimi shtyhet për një datë të mëvonshme, parashikuar nga pika 3,5 e Manualit.

Veprimtaria e KVR mbështetet nga Sekretariatit teknik i cili përbëhet nga (1) një ose më shumë punonjës të bashkisë të ngarkuar nga Kryetari me këtë detyrë. Caktimi i anëtarëve të sekretariatit teknik e procedura e thirrjes së mbledhjes apo elemente të tjera për funksionimin e KVR-së, përcaktohen në rregulloren e brendshme, e cila miratohet nga Kryetari i Bashkisë për rininë, parashikuar nga pika 3,6 e Manualit.

Sekretari teknik thërret mbledhjet në bazë të nevojave që shprehen nga radhët e Kryetarit ose të anëtarëve. Sekretari teknik njofton anëtarët e KVR-së, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara për datën dhe orën e takimit, si dhe rendin e ditës. Në çdo mbledhje të KVR-së mbahet procesverbali nga sekretariati teknik që pasqyron minutat e takimit dhe të gjitha diskutimet gjatë mbledhjes. Procesverbali nënshkruhet nga çdo pjesëmarrës në mbledhjen përkatëse të KVR-së, parashikuar nga pikat 3,5,1 dhe 3,7 të Manualit.

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: [info@vaudejes.gov.al](mailto:info@vaudejes.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mandati i anëtarit të KVR-së mbaron kur:

- a. përfundon afati dyvjeçar nga data e emërimit (parashikuar nga pika 3,2 e Manualit ) ;
- b. humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykate apo dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- c. jep dorëheqjen.

Anëtari i Këshillit Vendor të Rinisë lirohet nga detyra, para mandatit, nga kryesuesi i KVR me më shumë se  $\frac{1}{2}$  e votave, në rastet kur:

- a. nuk paraqitet, pa shkaqe të justifikuara, në të paktën 3 (tri) mbledhje të njëpasnjëshme të KVR-së ( parashikuar nga pika 3,5 e Manualit );
- b. paraqiten shkaqe objektive, që e bëjnë të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;
- c. nuk përmbush detyrimet si anëtar i KVR-së;
- d. veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtonuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e KVR.

Anëtari i KVR-se, të cilit i është ndërprerë mandati apo është liruar nga detyra, zëvendësohet nga kryesuesi dhe sekretariati teknik me një kandidat që përmbush kriteret e percaktuara në këtë vendim, i cili ka qënë i kandiduar.

Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit zëvendësues është sa pjesa e mbetur e mandatit të anëtarit të larguar.

Anëtari pajiset me referencë të lëshuar nga Kryetari i Bashkisë për kontributin e dhënë në sektorin e rinisë.

### **Detyrar dhe detyrimet e Këshillit Rinor Vendor Vau Dejës.**

1. Promovon projektet dhe iniciativat për të rinjtë iniciuar nga Bashkia Vau Dejës dhe nga organizatat e shoqërisë civile;
2. Këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: [info@vaudejes.gov.al](mailto:info@vaudejes.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. Merr pjesë në trajnimt e propozuara nga aktorët publik dhe jopublik për ngritjen e kapaciteteve.
4. Vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
5. Nxitë takime, diskutime me të rintë në gjithë territorin e Bashkisë Vau Dejës;
6. Propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjvë në territorin ku veprojnë;
7. Harton, miraton dhe publikon thirrjet për projektpropozime drejtuar organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë;
8. Ndjek dhe zhvillon veprimtari rinore, kulturore, artistike, letrare, sportive, të mbrojtjes së mjedisit dhe edukimin joformal, si dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve, në zbatim të politikave dhe programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për rininë.
9. Jep informacion ndaj të rinjve dhe/ose organizatave rinore për thirrjet për aplikime në projekte rinore të organizatave të ndryshme jofitimprurëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vendin tonë dhe atyre ndërkombëtare;
10. Ofron shërbime të ndryshme komunitare, nëpërmjet sigurimit të pjesëmarrjes aktive të të rinjve, për përmirësimin e jetës shoqërore në komunitetet e tyre;
11. Monitoron zbatimin e projekteve, që kanë përfituar mbështetje financiare.
12. Bashkëpunon me organizata të ndryshme rinore në nivel vendor, qendror dhe rajonal.
13. Ngre sipas nevojave grupe pune për çështje që lidhen me të rinjtë dhe përcakton përbërjen dhe rregullat e funksionimit të tyre.

### **Përfitimet e të qenit pjesë e Këshillit Vendor Rinor Vendor VAU DEJËS**

Të rinjtë të cilët bëhen pjesë e Këshillit Vendor Rinor Vau Dejës, padyshim që përmirësojnë aftësitë e tyre në:

Komunikim	Mendimin Kritik
Hartim projektesh	Zgjidhjen e Problemeve
Gjuhen Angleze	Punën në grup
Teknologji	Krijimtari

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-maile-mail: [info@vaudejes.gov.al](mailto:info@vaudejes.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Pjesmarrësit aftësohen duke hyrë në marrëdhënie bashkëvepruese me bashkëmoshatarët e tyre ngatë gjithë komunitetet e qytetit, duke përfshirë këtu edhe Kryetarin e Bashkisë si dhe Këshillin Bashkiak. Gjithashtu, krijojnë mundësi të takohen me profesionistë të ndryshëm të fushës së artit dhe kulturës, OJF- së dhe biznesit etj.

**DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE, ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT,  
SEKTORIT I ARSIMIT, RINISË DHE SPORTI**

Konceptoi: P/Sektorit të Arsimit

Melita Vjerdha

Miratoi: Drejtor Drejtorie

Devis Peci